

Fjala e kryetarit të Akademisë, akademik Mehmet Kraja, në mbledhjen komemorative për Minir Dushin

Të nderuar miq, akademikë dhe të tjerë të pranishëm!

E nderuara familja Dushi!

Në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ju ftoj që me një minutë heshtje të nderojmë emrin, jetën, veprën dhe personalitetin e akademik Minir Dushit.

I përjetshëm qoftë kujtimi për akademik Minir Dushin.

Lajmi për ikjen në amshim të Minir Dushit na la të trishtuar, mbase edhe për faktin se radha e atyre që ishin pjesë e fillimeve të këtij institucioni është rralluar ndjeshëm. Dhe jo vetëm i fillimeve të Akademisë, por edhe të institucioneve të tjera emblematike, nëse mund t'i quajmë kështu. Ai ishte anëtar i Akademisë plot pesëdhjetë vjet, që nga themelimi i saj. Ishte prorektori i parë i Universitetit të Prishtinës, më pas rektor në një kohë të vështirë, dekan i Fakultetit Xehetar-metalurgjik, inxhinieri i parë shqiptar që zbriti në galeritë e Trepçës dhe anëtar i Kryesisë së KSA të Kosovës.

Me një fjalë, akademik Minir Dushi, duke qenë pjesëmarrës në themelimin ndërtimin e institucioneve më prestigjioze të arsimit dhe shkencës në Kosovë, ai u bë edhe sinonim i tyre. Ishte institucionalist në kuptimin më pozitiv të fjalës.

Ky fakt, pra respekti që ai kishte për institucionet bëri që të ishte i ndjeshëm dhe në shumë raste i pakompromis ndaj atyre që lëndonin në çfarëdo forme prestigjin, ligjshmërinë dhe rregullsinë institucionale. Kjo ndjeshmëri i dha atributet e njeriut parimor. Më anë tjetër, puna e gjatë në institucione i dha atributet edhe të profesionistit, që i jep kuptim jetës, duke e kthyer në ideal punën për interes të përgjithshëm, për prosperitet dhe arritje domethënëse në fushën e dijes dhe të shkencës.

Disa vjet më parë, më ka takuar rasti që të bashkëpunoj për një kohë me akademik Minir Dushin, në hartimin e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës. Ai drejtonte redaksinë e shkencave teknike dhe që atëherë më ka mbetur konsiderata për njeriun e përkushtuar me krejt qenien e tij, për të përmbushur synimin e përbashkët të hartimit të një teksti të denjë për arritjet tona në fushën e shkencës dhe të dijes. Më ka bërë përshtypje veçmas fakti se ai fliste dhe shkruante me një konsideratë të jashtëzakonshme për pasuritë e tokës dhe të nëntokës së Kosovës.

Akademik Minir Dushi, sikundër edhe më të spikaturit e gjeneratës së tij, ishin iluministë të paepur. Ishte brez që i patën mision kultivimin e dijes shkencore dhe ngritjen arsimore. Jetën e tyre e projektuan të pandarë nga idetë iluministe, nga idealet e emancipimit shoqëror dhe kombëtar.

Në fund më lejoni të them se ikja e akademik Minir Dushit le një vend të zbrazët në Akademinë tonë, një vend të zbrazët ndër ata që për shumë kohë ishin emblema e këtij institucioni.

Ju faleminderit.